

# **Regullorja e punës së organeve të PDSH-së**

## **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Qëllimi**

#### **Neni 1**

Kjo Rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të PDSH-së të organeve, të trupave të punës, të drejtat dhe detyrat e delegatëve.

#### **Neni 2**

Kuvendin e PDSH-së e hap dhe me punën e tij udhëheq kryetari i partisë deri në zgjedhjen e kryesis së punës.

Kryesin e punës prej pesë (5) anëtarëve e zgjedh Kuvendi, të cilët i propozon kryetari i partisë

Kryesia e punës kujdeset për ecurinë e punës së kuvendit dhe trupave tjerë ndihmës të kuvendit.

Propozon dhe ndërmerr masa me karakter procedural si dhe propozon zgjidhje të tjera me rëndësi për efikasitetin e punës së kuvendit dhe jep sqarime për dispozitat e kësaj rregulloreje.

#### **Neni 3**

Puna e kuvendit zhvillohet sipas rendit të ditës i cili verifikohet në fillim të punës së tij.

Për ndryshime dhe plotësime të rendit të ditës vendos kuvendi në bazë të propozimit të arsyetuar.

#### **Neni 4**

Në punën e kuvendit marrin pjesë:

- 1) delegatët e zgjedhur nga nëndegët;
  - 2) aktivet;
  - 3) forumet;
  - 4) anëtarët e kryesisë qendrore;
  - 5) kryetarët e degëve dhe nëndegëve të PDSH-së;
  - 6) këshilltarët e Kuvendeve Komunale;
  - 7) anëtarët e Këshillit Qendror;
  - 8) anëtarët e Këshillit Kombëtar Shqiptarë;
  - 9) mysafirët e ftuar;
  - 10) përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik
- Të drejtë vote kanë vetëm delegatët e zgjedhur.

#### **Neni 5**

Vendimet e Kuvendit dhe të KQ të subjektit janë të plotëfuqishme nëse në punën e organeve përkatëse marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve që e përbëjnë organin dhe nëse për to votojnë shumica e të pranishmëve.

Çdo propozim mirret në shqyrtim.

Nëse paraqiten disa propozime, vendimi merret në atë mënyrë që votohet në bazë të rendit të paraqitjes së propozimeve.

## **II.TRUPAT PUNUESE TË KUVENDIT**

Formimi dhe përbërja e trupave punues

### **Neni 6**

Kuvendi me propozim të kryesisë së punës zgjedh këta trupa punues:

- 1) komisionin verifikues prej tre (3) anëtarëve;
- 2) komisionin zgjedhor prej pesë (5) anëtarëve;
- 3) komisionet konstituohen në atë mënyrë që zgjedhin kryetarin ose udhëheqësin.

Trupat punues punojnë në mbledhje kurse vendimet i marrin me shumicë votash dhe për punën e tyre i raportojnë Kuvendit.

### **Neni 7**

Delegati merr pjesë aktivisht në punën e Kuvendit,diskuton, jep propozime, vërejtje, sugjerime si dhe propozime me shkrim në tekstet e dokumenteve të cilat i miraton Kuvendi.

### **Neni 8**

Diskutimi në Kuvend zhvillohet sipas rendit të ditës që e përcakton kryesia e punës, në bazë të paralajmërimeve me shkrim të diskutuesve. Fletparaqitja për diskutim duhet të përmbajë emrin, mbiemrin nga i cili organ është i deleguar.

Delegati i cili dëshiron të bëjë pyetje të karakterit procedural ose diçka të sqarojë, të bëjë replikë lidhur me ndonjë diskutim, kryesuesi i jep fjalën, pavarësisht nga rendi i përcaktuar.

Delegati në diskutimin e të cilit bëhet vërejtja ose shtrohet pyetja, ka të drejtë në përgjigje.

Vërejtja, përgjigja ose pyetja veç e veç, nuk mundë të zgjasin më shumë se tre (3) minuta.

Çdo delegatë i Kuvendit ka të drejtë që për të njëjtën çështje apo pikë të rendit të ditës të flas vetëm një herë.

Pjesëmarrësit në diskutim flasin nga foltorja.

### **Neni 9**

Diskutuesit janë të obliguar t'i përmbahen rendit të ditës.

Diskutuesi që nuk i përmbahet rendit të ditës, kryesia e punës do t'i tërheq vërejtjen për këtë.

Nëse edhe pas tërheqjes së vërejtjes diskutuesi vazhdon të mos i përmbahet rendit të ditës, kryesuesi ka të drejtë t'ia merr fjalën.

Kryesia e punës mund të vendosë që t'i merret fjala anëtarit të Kuvendit po qe se konstaton se ai e ka kaluar kohen e caktuar me Rregullore dhe në raste kur ai gjatë diskutimit të tij është larguar nga rendi i ditës, por pasi t'i jetë bërë vërejtja paraprake.

### **Neni 10**

Diskutimet në Kuvend stenografohen dhe inçizohen dhe në bazë të tyre formulohet procesverbali për punën e Kuvendit.

### **Neni 11**

Raportet e trupave punuese i miraton Kuvendi, me kërkesën e delegatit që ka propozuar ndryshimin e dokumentit të Kuvendit.

Propozimi i delegatit të cilit nuk i është miratuar kërkesa, grupi i punës është i obligueshëm të jap sqarime plotësuese.

### **Neni 12**

Pas miratimit të raporteve të trupave punuese, kalohet në miratimin e dokumenteve të Kuvendit.

### **Neni 13**

Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve të Kuvendit

Vendimet e Kuvendit janë të plotëfuqishme nëse në punën e Kuvendit marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve që e përbëjnë organin dhe nëse për to votojnë shumica e të pranishmëve.

Prania e delegatëve në mbledhje verifikohet me ngritje të dorës ose me thirrje të emrave.

Për mënyrën e verifikimit të pranisë së deputetëve, vendos kryesuesi i mbledhjes. Zgjedhja e organeve të PDSH-së bëhet me vota të fshehta.

Në rastin e votimit të fshehtë, për hirë të transparencës dhe gjithpërfshirjes në organet e partisë, delegati obligohet që të votoj secilën listë të propozuar, përndryshe fletëvotimi do të llogaritet i pavlefshëm.

Vendimet tjera mirren me votim të hapur.

Votimi është personal.

## **III. ZGJEDHJA E KRYETARIT TË PDSH-SË**

### **Neni 14**

Kandidat për kryetar të PDSH-së mundë të jet çdo anëtarë i partisë i cili grumbullon së paku 30 nënshkrime nga delegatët e përbërjes së re të kuvendit të PDSH-së.

Lista me nënshkrime të kandidatit i dorëzohet komisionit zgjedhor në kuadër të Partisë të cilin e zgjedh KQ i partisë, së paku shtatë(7) ditë para mbajtjes së Kuvendit zgjedhor të Partisë.

Në rastë se në raundin e parë të votimeve kemi më tepër se dy kandidat, zgjidhet kandidati i cili ka marrë shumicën nga numri i përgjithshëm i delegatëve prezent.

Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e ka marrë numrin e mjaftueshëm për tu zgjedhur, në raundin e dytë kandidohen dy prej tyre që kanë arrijt numrin më të madh të votave.

Për kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madhë të votave të atyre që kanë votuar.

Në fletëvotimin për zgjedhje të kryetarit të partisë, kandidatët radhiten sipas renditjes alfabetike duke shënuar numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të cdo kandidati.

Votohet vetem per njërin (1) kandidat, duke rrethuar numrin rendor përpara emrit të kandidatit.

Në rastë se kemi vetëm një kandidat për kryetar të PDSH-se, delegatët e kuvendit me votim te hapur vendosin per menyren e votimit dhe ate:

- 1) votimi me aklamacion, pra me ngritje dore;
- 2) ose me votim të fshehtë.

## **IV. ZGJEDHJA E KËSHILLIT QENDROR TË PDSH-së**

### **Neni 15**

Anëtarët e Këshillit Qendror të PDSH-së zgjidhen nga delegatët e Kuvendit të partisë duke marrë parasyshë përfaqësimin gjithpërfshirës në bazë të listave të propozuara nga degët, nëndegët, forumet dhe aktivet.

Delegatët sipas funksioneve bazuar në statutin e partisë radhiten në listat, sipas venbanimeve, nëndegëve, forumeve apo aktiveve prej nga përfaqësohen.

Propozuesit e listave të delegatëve propozojnë anëtarët e Këshillit Qendror.

Nga lista e delegatëve të propozuesit për anëtar të Këshillit Qendror propozohet numri i përafërt i fituar si vlerë e herësit të numrit të delegatëve në listë nda për tre (3) plus një anëtar më tepër i cili gjithashtu të jetë nga lista e delegatëve të propozuesit.

Propozuesit e listave të delegatëve për anëtar të Këshillit Qendror mund të propozojnë edhe një anëtar më tepër për delegate të Kuvendit, i cili njëkohësisht është edhe i propozuar për anëtar të Këshillit Qendror, nga gjinia më pakë e përfaqësuar në listen e delegatëve të propozuesit.

Delegatët e Kuvendit votojnë secilën listë të propozuesëve. Nga secila listë votohet një më pak se numri i propozuar nga propozuesi.

Nga të gjitha listat e propozuesëve formohet lista e veçantë e delegatëve të gjinisë më pakë të përfaqësuar në Kuvendin e partisë.

Në listen e veçantë të delegatëve të gjinisë më pakë të përfaqësuar votohet një më shumë se gjysma e tyre për anëtar të Këshillit Qendror të PDSH-së.

Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk votohet numri i mjaftueshëm i anëtarëve në cilëndo listë, nëse ka të votuar më shumë ose më pakë apo edhe në raste të tjera bazuar në ligjin zgjedhorë për pushtet lokal.

Listat përpilohen në bazë të alfabetit sipas emrit të delegatit.

Në rastë se kandidatët brenda listës kanë numër të njejtë të votave, atëherë zgjedhet ai i cili është i radhitur më lartë në listë sipas renditjes paraprake alfabetike.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Qendror konstatohet në Kuvendin e partisë pas votimit

Këshilli Qendror mblidhet më së voni 15 ditë pas mbajtjes së Kuvendit.

Këshillin Qendror të degës së Preshevës e përbëjnë anëtarët e KQ të PDSH-së nga teritori i Komunës së Preshevës.

Mbledhjen e Këshillit Qendror e konvokon Kryetari, Kryesia e Partisë si dhe nëse këtë e kërkojnë 1/3 e anëtarëve të KQ.

Mbledhja e Këshillit Qendrorë konvokohet sipas nevojës ose së paku një herë në vit, e sidomos para dhe pas zgjedhjeve të çfarëdo niveli.

## **V.ZGJEDHJA E KRYESISË SË PDSH-së**

### **Neni 16**

Kryesia e PDSH-së numëron 18 anëtarë dhe kryetarin, prej te cilëve 30% nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Kryesinë e subjektit e zgjedhë Këshilli Qendror i subjektit.

Zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet me vota të fshehta nga anëtarët e Këshillit Qendror të subjektit.

Kryesia e përgjithshme e PDSH-së zgjedhet në mbledhjen e parë të Këshillit Qendror, më së voni 15 ditë pas mbajtjes së Kuvendit.

Kryesia zgjedhet në atë mënyrë ku përcaktohet lista e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Qendror.

Anëtarët e Këshillit Qendror zgjedhen në atë mënyrë ku çdo anëtar i Këshillit Qendror rrethon 18 emra nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Qendror të cilët janë të propozuar në listë.

Në rastin kur më shumë se një kandidat ka numër të njëjtë të votave atëherë në mes të kandidatëve me numër të njëjtë të votave zgjedhet kandidati sipas radhitjes alfabetike- Emrit të Kandidatit.

Të gjithë anëtarët e Këshillit Qendror kanë të drejtë të votojnë dhe të jenë të votuar.

Në listën për zgjedhjen e kryesisë së PDSH-së votohen tetëmbëdhjetë (18) anëtarë.

Fletëvotimi është i vlefshëm nëse janë të votuar tetëmbëdhjetë (18) anëtarë.

Në secilin rast tjetër fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm.

Nëse dy e më tepër kandidat për anëtar kryesie kanë numër të barabartë të votave, votimi përsëritet derisa të zgjedhet njëri prej tyre.

## **VI.ZGJEDHJA E NËNKRYETARËVE DHE SEKRETARIT TË PDSH-së**

### **Neni 17**

Nënkryetarët e partisë dhe sekretarin i zgjedh Kryesia e partisë.

Njëri nga nënkryetarët e partisë duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar në Kryesinë e përgjithshme të partisë.

Nënkryetarët për punën e vet i përgjigjen Kryetarit të Partisë, Këshillit Qendror dhe Kuvendit të Partisë.

Kryesia me vota të fshehta zgjedh nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm të partisë.

## **VII. PËRCAKTIMI DHE SHPALLJA E REZULATAVE ZGJEDHORE**

### **Neni 18**

Komisionet dhe trupat tjerë punues konstatojnë se të gjithë delegatëve prezent i është mundësuar të votojnë, dhe fillon procedurën e vërtetimit të rezultateve të votimit me këtë rradhitje:

- 1) vërtetohet numri i fletëvotimeve të hartuara,
- 2) vërtetohet numri i delegatëve që janë prezent në Kuvendin zgjedhor,
- 3) vërtetohet numri i delegatëve që kanë pranuar fletëvotimet,
- 4) vërtetohet numri i fletëvotimeve të papërdorura, të cilat do të vulosen në koverta,

- 5)hapet kutija e votimit dhe me numrimin vërteton numrin e fletëvotimeve në kuti,
- 6) vërteton numrin e fletëvotimeve të vlefshme,
- 7)vërteton numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, që ndahen dhe vulosen në kovertë të veçantë,
- 8) vërtetohet numri i votave që ka marrë kandidati i propozuar.

Fletëvotimet e pavlefshme nënkuptohen:

- 1) fletëvotimet e paplotësuara,
- 2) fletëvotimi i plotësuar ashtu që nuk mund të vërtetohet me siguri për kend ka votuar delegati,
- 3) si dhe fletëvotimi ku janë rrethuar më tepër kandidat nga numri që zgjedhen.

### **Neni 19**

Formularin për zgjedhjet për të gjitha nivelet e partisë i përgatisin bashkërisht Komisioni për zgjedhje dhe Komisioni Statutar i Partisë Demokratike Shqiptare.

Formulari i procedurës dhe delegimi i delegatëve për Kuvendin e VII-të zgjedhor, përgatitet në bazë të Rregullorës.

### **Neni 20**

Procedura e zgjedhjes së organeve të përgjithshme të partisë vlen edhe për zgjedhje të organeve të degëve të PDSH-së.

### **Neni 21**

Kjo rregullore hyn në fuqi prej ditës së miratimit nga ana e Këshillit Qendror të PDSH-së.

## **KËSHILLI QENDROR I PDSH-së**

Në Preshevë  
Më 11.10..2020



Kryetari  
Dr. Sc. Ragmi Mustafa